



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

VENDIM

Nr. 3, datë 15.09.2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR
PËR NXJERRJE UJI”, SHOQËRISË “QENDRA PEMA E JETËS”
SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji”, shoqërisë “Qendra Pema e Jetës” sh.p.k., me vendndodhje, Njësia Administrative Bërzhitë, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Pus-shpim

Vendndodhja e shpimit

- X=492296.42
- Y=4566685.95
- Z=760 m m n d

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji

- X=492338.73
- Y=4566714.36
- Z=259 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU ERZEN

MERSIN MURATI

